

INTERVISTË ME FERDEZE MUJAJ SADIKUN

Prishtinë | Data: 13 mars, 2024

Kohëzgjatja: 79 minuta

Të pranishëm:

- Ferdeze Mujaj Sadiku (E intervistuar)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Ana Morina (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zonja Ferdeze, nëse mundeni me u prezentu edhe me na tregu diçka për familjen, prejardhjen e juj?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Po. Unë jam Ferdeze Mujaj nga... e lindur në fshatin Hogosht të Komunës së Kamenicës. Kam ni familje që e çmoj dhe e respektoj. Im atë ka qenë një ndër mësuesit e parë në Komunën e Kamenicës. Ka hapë nja dy shkolla shqipe n'atë kohë. Se nga vitet '40-'46 ka qenë si mësues. Ndoshta frymëzimin e parë ose dijen e kam marrë nga ai, nga librat të cilat i mbanim në shtëpinë tonë të cilat disa ishin edhe të ndaluara në atë kohë. Kështu që kam patur nënën, vëllezërit, motrat.

Tani vjen normalisht jam e martuar, jam gjyshe. Kam bashkëshortin ni djalë edhe ni vajzë, ni mbesë edhe tre nipër. Punoj akoma edhe pse ka kohë që jam e pensionuar punoj. Sepse puna më sjellë kënaqësi dhe elan, kështu që ndjehem më mirë.

Anita Susuri: E përmendet babën e juj, ku osht' shkollu ai? Si është shkollu n'atë kohë?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Shife, n'atë kohë tash nuk mund t'i them shumë se fort ndoshta nuk i kom shiku. Është shkolluar në fillimisht e ka ni shkollë fetare që ka qenë përpara mandej ka fillu, është detyruar në gjuhën serbe. Pastaj shkollën normale edhe mandej nëpër këto, kanë qenë disa kurse që janë mbajtur n'atë kohë që vërtetë unë nuk i di. Kanë qenë në qytete të ndryshme. E di që në Prizren, në Gjakovë e në disa qytete të Kosovës. Faktikisht ai ka qenë një ndër... 40 e diçka vite ka punu si mësues tani është i ndjerë.

Anita Susuri: E për nanën e juj' diçka? Çfare ka qenë?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Nana ime ka qenë një grua amvise. Na ka shërby, na ka eduku. Kemi mendu... e falënderoj. Para pak muaj ka ndrruar jetë në moshën 90 vjeçare. Kështu që jam shumë falenderuese që jam bija e saj.

Anita Susuri: Thatë që keni pasë edhe vëllezër e motra. Sa fëmi keni qenë gjithsej?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Po gjashtë fëmijë tre motra edhe tre vllazër. Të gjithë jemi në fakt të shkolluar, punojmë akoma. Unë jam fëmija i parë i prindërve të mi...

Anita Susuri: A fëmija i parë.

Ferdeze Mujaj Sadiku: Po, fëmija i parë i prindërve të mi.

Anita Susuri: A keni pasë ma shumë përgjegjësi si ma e madhja?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Po unë normal kam patur përgjegjësi po shumë shpejt u largova nga ata faktikisht. 14-15 vjeçe erdha në Prishtinë në shkollën e mesme. Pastaj, vajta në Shqipëri kështu që shumë pak. Pasi u ktheva nga ajo, po, kom patur, kom ndihmuar materialisht. Jam mundu t'i shkolloj. T'ju ndihmoj vëllezërve nga aq sa kam mundur atë kohë. Kështu që sot e asaj dite kam një përgjegjësi sepse jam më e madhja në familje.

Anita Susuri: Po m'intereson edhe vendi ku jeni lind, ku jeni rritë çfare ka qenë?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Shife, Hogoshti ka qenë një ndër fshatrat më të emancipuara mendoj në atë kohë sidomos pas viteve të '70-ta kur unë nuk kam jetuar më aty. Është hapur gjimnazi dhe aty janë shkolluar pothuajse i tërë rrethi i... ato fshatrat që kanë qenë rreth Hogoshtit. Hogoshti ka pasë njerëz shumë intelektual, ka patur shumë patriot. Në atë kohë ka patur shumë djem të burgosur edhe vajza të burgosura nga regjimi jugosllav. Tani ka ndryshuar sepse t'rinjtë ma edhe po largohen nga fshatrat.

Akoma shkoj e kom atë nostalgjinë sepse kam vëllaun atje. Kështu që ne jemi faktikisht tre motra. Ni moter është profesoreshë e gjuhës, dy vëllezër janë ekonomista, ni vëlla edhe ni motër jetojnë në Bruksel nga vitet e '90-ta kështu që...

Anita Susuri: Ju keni qenë shumë e vogël po ka qenë kjo periudha viteve të '60-ta periudha e Rankoviqit që njihet. A ju kujtohet?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Shife, unë faktikisht klasën e parë e kam filluar në 1960-ten. Kam shkuar si gjashtë vjeçe m'ka çu im atë në shkollë meqë ai ishte mësues edhe vrejti që kisha, isha pak ma e ditur ndoshta për shkak të ndikimit të babait tim. Fillova shkollën në Hogosht. Kishim, ishim shumë pak vajza në atë kohë sepse edhe pse ishte një ndër fshatrat më të ngritura po ishin kohëra tjera që nuk mund të imagjinoni. Ishin vajza të mbuluara, jo si tani po me ato çarçafa që kanë qenë një pjesë e madhe e tyre. Më pak i lejonin të shkonin në shkollë.

Bile unë në klasën e tetë kur e kemi kry kemi qenë vetëm katër vajza. Ishin pothuajse 40 djem dhe vajza ishin vetëm katra. Vetëm unë vajta në shkollë të mesme ato nuk i lejuan asnjëherë n'atë kohë të

shkolloheshin. Kështu që Hogoshti është, ishte ndër fshatrat ma të emancipuara në atë kohë po pastaj u shkolluan. Pas hapjes së gjimnazit vajzat ishin shkolluar pothuajse të gjitha, pothuajse të gjitha.

Anita Susuri: Po m'interesoq që thatë kom ardhë në Prishtinë. A ka qenë e vështirë për shembull...

Ferdeze Mujaj Sadiku: Po, për në atë kohë ishte shumë e vështirë sepse ajo ideja që vajza po del prej shpisë çfarë do ndodhi me të, me kë do rrijë, me kë do ashtu... e atë që thatë për kohën e Rankoviqit, thashë unë kom qenë në ato vite '60-të e '70-të kam dëgjuar babain se babai ishte mësues dhe gjithmonë normal është frikësuar se mos po i ndodhë diçka sepse ishte regjimi i tillë që... po mandej mbas '68-tes mbas largimit të Rankoviqit, '66-ten mesa më kujtohet e mbaj mend që fliste im atë në shtëpi u... pak ishte ma e relaksuar situata në atë kohë.

Mandej mbas viteve të '70-ta, '74 me siguri unë ma nuk kam jetuar këtu. Po edhe atëherë dihet se kam lexu dhe kam pa se çka, se çka flitej. Sepse lexonim gazetatat. Im atë kishte libra mjaft shumë në shtëpi. Shumë e re kam fillu t'lexoj. Ndoshta nga klasa e katër-pestë kam fillu kam lexu romanet që i sillte im atë në shtëpi. Edhe ajo ndoshta ka ndiku edhe për të ardhmen time, ndikimin tim që vajta pastaj në Shqipëri në atë moshë aq të re.

Anita Susuri: A ju kujtohet nëse baba ju ka tërhequr vëmendjen që mos me folë, mos m'i tregu gjithkujt për libra?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Po patjetër. Librat e shtëpisë time nuk kanë qenë brenda sikur janë këto për shembull {tregon me gisht tek disa libra brenda shtëpisë}, po ne i themi tavan i themi atë. Unë tanë ditën rrija aty. Ndonjëherë edhe nëna ime më thërriste nuk e dinte ku jam. Unë hypur tanë ditën, shumë e re, në tavan sepse kishte plot libra. Në '68-ten mbaj mend e kam lexuar "Gjarpërinjtë e Gjakut", të Adem Demaçit. Ndoshta nuk e kam kuptuar aq taman se çfarë, çfarë ka dashur t'thotë autori por ai ishte libër shumë i ndaluar. Unë katin e tretë... i pari, i dyti, i treti të shtëpisë siç ishin atëherë në fshat në tavan kam lexuar atë libër ose... ishte shumë errët, s'di si e lexoja. Kurioziteti ma tepër që ta shof se çfarë po shkruhet në të.

Anita Susuri: A keni pasë shoqe, shok që keni mujtë me bisedu për to?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Shumë pak. Shumë pak sepse, jo veç për shkak të mentalitetit po më vjen keq të them se ma pak ndoshta kishte intelektual po fëmijë, ata intelektual ndoshta ni pjesë ishin larguar nga Hogoshti edhe s'kishe me kë të bisedoje për këtë. Ishte ajo frika se m'thonin prindërit nuk është mirë të bisedosh se çfarë lexon. Im atë e dinte krejt se çfarë lexoja.

Anita Susuri: E kur vendosët në Prishtinë me ardhë si ju duk krejt ky ndryshim?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Shife, këtu kur kam ardhë në Prishtinë më shumë se... faktikisht ne kishim rreth 14 lëndë, tetë, jo dymbëdhjetë lëndë më fal, tetë i kemi pasë në gjuhën serbe. Sepse nuk kishte kuadro shqiptarë këtu në shkollën e mesme mjekësore. Ishin të dy nacionalitetet. Ishim të ndarë ne si shqiptarë në klasën tonë por lëndët i kishim në gjuhën serbe sepse nuk kishim kuadro në atë kohë. Ishte shkollë mjekësore kishte shumë pak kuadro. Nuk ishte e lehtë edhe për neve si nxënës se nuk e dinim gjuhën serbo-kroate po detyroheshim. Kishte rregulla shumë strike në atë kohë.

Kishte nxënës shumë të mirë, kishte vajza të gjitha rretheve të cilat bile kishin ikur nga shtëpitë edhe ishin ardhë në shkollë, në konvikt. Kishin... ato kishin fitu disa bursa të mira në atë kohë. Nuk ishin shumë por ishin disa mbaj mend në shkollën mjekësore.

Anita Susuri: Keni jetu në konvikt apo?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Jo, jo, jo. Kam jetuar me ni familje që e kishim të njohur. Mandej në vitin e dytë kur fillova që ika në Shqipëri isha e vendosur në konvikt. Faktikisht vetëm dhjetë ditë, domethanë me datën, 17, jo dhjetë ditë se fillonte shkolla në atë kohë me 7 shtator mesa më kujtohet. Unë me 17 ika, faktikisht vetëm dhjetë [ditë] m'ra. Ishte ai konvikti i shkollave të mesme që tani është policia mesa di aty në atë konvikt, aty kah parku i qytetit. Ni konvikt shumë i mirë.

Anita Susuri: E paraprakisht para se të flasim për domethanë krejt rrethanat për me shku në Shqipëri, po më intereson pak edhe përshtypja juaj e Prishtinës n'atë kohë. Si ka qenë Prishtina?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Po Prishtina ishte ni vend i qetë, ishin ato korzot e mramjes po ne ishim shumë të reja veç e dinim rasisht nëse kemi kalu me prind ose diçka. Ishte vend i qetë. Normalisht ishte e ndarë korzo e shqiptarëve dhe korzoja e nacionalitetit tjetër e serbëve, në përgjithësi. Kishte ndoshta edhe të përzier por llogarite se ajo pjesa andej është e atyre kjo këndej e jona. Mbaj mend demonstratat e '68-tes kam qenë në Prishtinë. Vetëm në radio kur i dëgjum se ne ishim të ri shumë. Kur dola i pashë ato parullat që ishin vendosë para teatrit.

Sot m'kujtohet, "Vetëvendosje!" ishte ni parullë. Kishin thyer ca xhama. Fiks para Teatrit Krahinor¹, para teatrit që është ktu në Prishtinë. Ato burgosjet ato që dëgjuam pastaj prej... në radio nëpër lajme gazeta që u burgosën të rinjtë. Kishte edhe vajza pjesëmarrëse studente n'atë kohë. Në ato demonstrata normal që na bënin përshtypje. Ndihehim pak më mirë, ma të fortë. Kështu që e mbaj mend atë rast. Prishtinën ishte krejt ndryshe, ishte e qetë, s'kishte këto lokalet e sotit absolutisht. Vajzat nuk shkonin në ato lokale. Mund të dilje në xhiro, në korzo xhiro të mbrëmjes ose diçka por jo si tani.

Anita Susuri: A ka pasë kështu jetë kulturore që keni marrë pjesë?

¹ Teatri Kombëtarë i Kosovës sot.

Ferdeze Mujaj Sadiku: Po ka patur. Ka patur për shembull në '68-ten mbaj mend filmi Skënderbeu kam shkuar e kam parë. Mesa më kujtohet nëse jom e sigurtë i thojshin Shtëpia e Armatës dikund ajo salla. E pashë filmin Skënderbeu edhe ka qenë salla e përmbushur. Më tepër ka pasë duartrokitje sesa që ka pasë sesa që e kanë shikuar filmin. Kryesisht të rinj po edhe intelektual edhe njerëz të tjerë plotë. Ka patur ndonjë... ka patur teatro. Teatri ka qenë mjaft i zhvilluar. E di që vinte im atë nga Hogoshti merre mu dhe shkonim në teatro për shembull.

Nuk më kujtohet tashti cila ndoshta Erveheja e kam parë n'atë kohë, nuk jam shumë e sigurt. Po këta normal aktorët e mëdhej që kanë qenë në Kosovë që ma nuk përsëriten, nuk do t'ketë ma. Malogami ka qenë ndër aktorët shumë të njohur. Nuk po m'kujtohen në qit' sekond të gjitha aktorët që ma nuk ka dhe s'e besoj që do të ketë aktorë të tillë.

Anita Susuri: Tash po m'intereson, ju paraprkisht a keni qenë në ndonjë organizatë? Në ndonjë organizim apo...

Ferdeze Mujaj Sadiku: Jo, jo, jo, jo. Nuk kam qenë. Nuk mund t'them që kam qenë. Jo.

Anita Susuri: E si ka ardhë deri te ideja me shku në Shqipëri?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Shife, ndoshta ajo, them këtë me sinqeritetin ma të madh, ndoshta kam qenë gjashtë vjeçe ose pesë se fëmiu mban mend. Kam qenë e shtrirë me im atë në shtrat ka qenë diçka si me temperaturë ose diçka tjetër. Ai ndoshta për me më qetësu, me siguri kam qenë ende pa fillu shkollën se nuk mund ta di, kam qenë pesë ose gjashtë vjeçe. Tha, "Unë ty", tha, "ti do ta krysh këtu shkollën tetë vjeçare po shkollën e mesme do t'çoj", tha, "në Shkollë Normale në Elbasan". Si sot më kujtohet edhe kjo jom shumë e sigurtë.

Unë dija pak a shumë se dëgjoja ato bisedat se kur je vetëm ni fëmi, se pesë vjet kam qenë vetëm unë pastaj kanë lind fëmitë e tjerë edhe kujdesi ishte më i madh tek unë edhe dëgjoja krejt çfarë fliteshin kur vinin njerëz të tjerë aty. "Sepse", tha, "deri atëherë do të shlirohet Kosova". Mendonte se për disa vite do të shlirohej dhe ne do... "Sepse unë", tha, "kam patur shumë dëshirë të jem", të ketë shkuar vet. Ka pasur dëshirë ta vazhdoj Shkollën Normale në Elbasan. Mësusin e tij e ka pasë ni mësus nga Elbasani këtu në Kosovë që ka punu meniherë pas lufte ai deri n'vitet '48-ta ka patur që kanë ardhë mësus në atë kohë.

Tha, "Do t'çoj". Kjo m'bëri përshtypje dhe më ngeli në mendje kjo fjalë që do shkoj unë në Elbasan në shkollë. Faktikisht pesë-gjashtë vjeçe isha. Gjatë gjithë kësaj kohe duke u rritë lexoja shumë, të tregova edhe kanë qenë... dëgjoja radion, kemi pasur radio. Tanë kohën unë Radio Tiranën më vonë filloj Radio Kukësi. Ishte ni emision për shqiptarët jashtë atdheut i Radio Tiranës. Ka qenë komplet i dedikuar vetëm për shqiptarët që ata të mësojnë, ta dijnë çfarë është Shqipëria, të krijojnë edhe emocione edhe dashuri edhe krejta.

Kishte... flitej për ato aksionet e rinisë, për, sidomos vitet nga '68-ten u bë elektrifikimi i Shqipërisë, i krejt Shqipërisë. Aksionet pajtimi i gjaqeve atje, pra nuk kishte ma vëlla vrasje, u ndalua plotësisht. U hoq ferehxha, u hoqën fetë, u ndaluan fetë, të gjitha fetë pa përjashtim. Se shqiptarët i kanë tre-katër fe prandaj ka edhe këto përçarje. Ai i hoqi të gjitha pa, pa përjashtim. Prishi domethënë i hoqi xhamiat, i la... ndoshta secilin qytet ka lënë ndoshta një xhami edhe një kishë që kanë qenë pak më me traditë diçka po në përgjithësi i ka hequr ato. Ni pjesë për shembull i ka bërë shkolla, i ka bërë shtëpia kulture, ka bërë ato ndërtesat fetare që kanë qenë.

Më bënin përshtypje aksionet e rinisë. Mbjaj mend është shumë interesant Shkurte Palvata ni aksioniste që u mbyt në aksion në hekurudhën Prenja Rogozhinë mesa m'kujtohet edhe ajo u shpall, u shpall komunistja e parë 15 vjeçare. Më bënin përshtypje mu këto gjana si e re, si... kujtoja që Shqipëria është diçka e jashtëzakonshme. Nuk do them se për mua ishte dhe ka mbetur poashtu dhe këto ndoshta ndikun disa gjana që i dëgjoja në radio. Muzika, këngët e bukura të Shqipërisë. Vaçe Zelën qysh në atë kohë e kom dëgju me shumë kërshtëri, në vitin '68, '69, '70. Mendoj që këto kanë qenë disa nga ndikimet që mezi kam pritë që a ka mundësi të shkoj atje.

Bile kur shkova në Shqipëri në kohën që isha në atë shtëpinë që ju tregova, shtëpi e pritjes quhej në fakt, po ishim të izoluar. Kur m'thanë, "Vendosi shteti për ty që ti t'vendosesh të jetosh në Shqipëri, të dham strehim politik dhe tani do shkosh në shkollë". Unë thashë, "Dua të shkoj në Elbasan në Shkollë Normale", thashë, "s'ka problem që kam bërë këtë vitin e parë këtu, do ta humbas, por do shkoj sepse im atë ka pasur dëshirë të shkoj në shkollë normale". "Jo", tha, "nuk ka nevojë, ke mbaruar. Pse do humbësh ni vit? Do t'çojmë në Vlorë edhe më mirë". Më çuan në Vlorë pastaj në shkollë mjekësore.

Anita Susuri: E për me shku atje a keni bisedu me dikënd a si?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Ndëgjo, mos të hy shumë në ato detale ndoshta se nuk po m'dukjet edhe e nevojshme. Ne kemi shku e kemi bo ni lloj organizimi edhe shkum nëpër kufirin nga Gjakova kalum në Tropojë brenda natës. Kemi udhëtuar tanë natën. Jemi nisë... mendoj nga ora 08:30 në mbrëmje dhe kemi mrri në 05:30 e mëngjesit. Ka qenë ni rrugë jashtëzakonisht e vështirë, e tmerrshme. Mbjaj mend që kemi kalu ni pyll që nuk është pa qielli. Kam qenë e veshur me këpucë pak të larta, me ni fun n'atë kohë shumë të shkurtë që i mbanim neve në Kosovë. Nuk kam qenë e pregaditur për këtë udhëtim. M'u dha rasti edhe vendosa.

Sa kemi kalu kufirin përnjëherësh na kanë ndalu ushtria shqiptare. Na kanë mbajtur ni natë aty kemi pushuar. Unë kam qenë krejt e gjakosur këmbëve, gjunjëve. Kam qenë komplet gjak. Sepse thashë isha pa diçka... të kisha qenë si tani e veshur me pantollona ose diçka tjetër shumë më lehtë e kisha patur. Aty u sollën jashtëzakonisht mirë pastaj na mbajtën tetë ditë në Bajram Curr. Normalisht të izoluar dhe mandej në Laç. Këta shoktë që kanë qenë, po të Hogoshtit, këta i kanë kthyer. Vetëm ni ditë jemi takuar me ta.

Ka qenë Rexhep Malaj, [Sami Dërmaku](#), Isa Kastrati. Ata janë dy heronjtë. Samiu edhe ai ka përjetu shumë trazira se ka qenë ish i burgosur e çka po di unë më tutje. Por ata u kthyn. Ata janë kthy me mision për këtë jam shumë e sigurt dhe kanë vazhduar atë derisa edhe u bënë heronj të Kosovës. Mu më mbajtën se unë isha e re, isha 16 vjeçare, ata kanë qenë 20 e diçka vjeçar, 20 po. Nuk e di edhe vet them ndonjëherë pse më mbajtën mu? Se në atë kohë ishte qenë ni marrëveshje mesa na tregun neve ata njerëzit që vishin nga sigurimi për t'u takuar me ne dhe për t'biseduar me ne.

Që nga '68-ta kish qenë ni marrëveshje me Jugosllavinë që asnji kosovar të mos mbahet në Shqipëri. Deri n'vitet, deri n'79-ten asni kosovar nuk, derisa unë jom kthy ma nuk është pranë kurrë në Shqipëri. Kanë ardhë po i kanë kthy meniherë, nuk i kanë lënë fare të dalin. Mbas vitit, mas '81-shit tani kanë shku, kur kanë ndodhë demonstratat mandej kanë shku, sa kanë shku nuk e di por ka pasur mjaft që kanë shku. E deri '79-ten, e fundit kam qenë unë, nuk ka patur të tjerë.

Anita Susuri: E në familje a keni tregu?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Jo, jo, jo, jo. Kjo ka qenë fatkeqësia ma e madhe se t'ju kisha tregu ata nuk do t'më lejonin normalisht. Pothuajse deri atë ditë që unë ju kom çu telegram mas tre mujve nga Vlora. "Jam mirë, ndodhem në Vlorë, mos keni merak", ata nuk e kanë ditë. Nga ditët e fundit ju kanë thanë mos ndoshta është por m'kanë lypë gjithkrah, m'kanë kërkuar nuk më kanë gjetë. Kanë qenë shumë të shqetësuar që ndoshta nuk ia fali këtë vetës sepse prind jam edhe unë tash edhe gjyshe dhe e di çka domethanë.

Po fati është që nuk kam shku ndonjë rrugë të keqe po kam shku në rrugë shumë të mirë që m'ka shërby edhe sot dhe i falënderohem ndoshta atij udhëtimi që kam bërë që sot kam dy fëmijë shumë të mirë të cilët i kam eduku me dashuri shumë të madhe ndoshta edhe për Shqipëri edhe ata ndoshta s'kontribojnë asgjë po bile nuk janë të këqinjë. Vet e kam këtë punë që atje jam shkollu, m'ka shkollu ai shtet me pa asni ndihmë të askujt tjetër vetëm me bursën e atij shtetit të asaj kohe që ka qenë.

Anita Susuri: Thatë që ju kanë dërgu prej aty pastaj në shtëpinë e pritjes, keni qenë tre muj?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Tre muaj, përafërsisht tre muaj, po.

Anita Susuri: Si kanë qenë kta tre muj? A jeni marrë me diçka?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Jo. Po s'kemi patur liri dalje për shembull, na kanë lanë vetëm brenda atij territorit aty. Unë flas për vete për ata çunat nuk e di se s'jam takuar kurrë, vetëm ni ditë jemi takuar që na kanë leju, vetëm ni natë. Kanë ardhë ni person nga Tirana që ka qenë i sigurimit të shtetit ka bisedu me neve dhe thotë që, "Shteti ka vendosë që ju të ktheheni". Normal ata kanë, nuk kanë pranë në asni mënyrë kanë kundërshtu deri në momentin e fundit. Vetëm ni ditë na kanë çu na kanë shëtite Tiranë

edhe në Durrës. Në oborr me orar të caktun. Kur kanë dalë ata mu nuk më kanë lënë për mos me pasë kontakte, për me bisedu se jo diçka tjetër.

Unë kam zbritë deri në kuzhinë aty ku ka bërë ajo që ka bërë Gonxhja e ka patur emrin që ka bërë ushqimin për neve. Kam nejt me të, kam biseduar një orë gjysë ore dhe mandej kam hyrë, kam shku lartë në katin e dytë...

Anita Susuri: E kur ju kanë shëtitë Tiranë, Durrës si ju është dukë juve kjo?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Po normal që më është dukë ni mrekulli, s'ka dikund më mirë se Tirana se Durrësi. Vetëm në Tiranë dhe në Durrës, po. Mbaj mend na çuan në Pallatin e Kulturës për t'pirë kafe. Në hotel Vollga ishte në Durrës kemi ngrënë darke. Ka qenë ni muzikë shumë e bukur edhe me ata njerëz të sigurimit normalisht. Kaq këto dy qytete dhe mu m'çun... erdhën më morën dhe më dërguan prej Laçit më dërguan në Vlorë.

Gjatë kohës sa kemi qëndru në Laç vazhdimisht kemi qenë n'pytje. Domethanë bisedime. Kryesisht kanë qenë disa persona që kanë qenë, që kanë punuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme në Shqipëri. Ka qenë, një ndër ta ka qenë Sali Shatri, një njeri shumë i mirë, një njeri shumë patriot. Nji person që ka kontribu për Kosovën jam shumë e sigurt, në atë kohë. Edhe Shaban Braha. Këta dytë kosovar por kanë shku ma herët vitet mesa di unë ndoshta të '50-ta në Shqipëri. Janë shkollu atje dhe kanë punu në Ministrinë e Punëve të Brendshme, kryesisht degën për kosovar. Ka qenë ni digaster për kosovar.

Ata kanë ardhë kanë bisedu. E kanë ditë gjendjen në Kosovë na kanë pytë si, tek, këto gjanat që ju kanë interesu atyne. Kur kanë vendosë me m'çu në Vlorë është lajmëru shkolla edhe m'kanë bërë ni pritje të jashtëzakonshme. Drejtorja e shkollës nxënës aty secilin... aty ishin disa degë të shkollës. Vinin për krahu më tërhiqnin, "Eja me neve". Ishte dega për farmaci, stomatologji, mjekësi e përgjithshme dhe infermieri. "Eja te na". Më tërhiqnin nga krahët, "Eja n'klasë me neve". Kam shku edhe aty edhe aty në fund mandej vendosa për farmaci. Se, a din, kam kalu mirë shumë.

Ka qenë ni trajtim i jashtëzakonshëm me ushqim, me veshje, me... edhe lapsat m'i ka ble shkolla mos t'flas për veshmbathje. Shkolla, shteti nuk di kah kanë ardhë ato por të gjitha, të gjitha. Me libra, me fletore me çka duhet për ni nxënëse. Edhe ushqimi pa, ni ushqim krejt solid normal si në konvikt që është.

Anita Susuri: Konviktet kanë qenë... e pashë n'foto që ma tregut, a ka pasë shumë vajza, shumë djem?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Po, aty kemi qenë mbi një mijë vajza dhe djem. Konvikti i vajzave ka qenë i veçantë. Gjithmonë kështu ka qenë n'atë kohë në Shqipëri. Konvikti i djemve ka qenë i veçantë. Mensa ka qenë normalisht e përbashkët, klastë kanë qenë të përbashkëta. Vetëm konviktet kanë qenë të

veçanta. Me ni oborr por edhe në fakultete kur kemi qenë në shkolla në fakultet konviktet kanë qenë të ndara në atë kohë. Nuk ka pasur shansë një vajzë të shkoj t'hyj në konviktin e djemve ose ni djalë t'hyjë në konviktin e vajzave. Në asni mënyrë. Ashtu ka qenë rregulli.

Qyteti i studentëve ka pasë 27 konvikte. 27 konvikte. Kanë qenë të gjitha mbi katër katëshe - pesë katëshe ka pasë edhe shtatë katëshe. Sepse n'atë kohë nuk ka patur, vetëm student të Tiranës që kanë qenë të Tiranës ata kanë banu në shtëpitë e veta. Nuk ka mujtë me banu studenti privatisht diku, vetëm në konvikt. Të gjithë kanë qenë me bursa, të gjithë, të gjithë. Shteti i ka shkollu. Edhe ata shqiptarët e Shqipërisë normalisht.

Por unë kam patur një bursë ma të madhe se ata tjetër për shembull. Ata e kanë patur bursën tre mijë lek të atëhershit që ka qenë konvikti dhe ju kanë mbetë nja 200 lek për do... unë e kam pasë 4800 lek edhe tre mijë lek konvikti 1800 lek m'kanë mbetur për harxhime tjera se meqenëse kam qenë pa familje. Kështu ka qenë rregulli për kosovar.

Anita Susuri: E pastaj në familje t'juj thatë që keni dërgu ni telegram...

Ferdeze Mujaj Sadiku: Po.

Anita Susuri: Po si ka qenë pastaj komunikimi?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Pastaj me letra, vetëm me letra. Letra ndoshta niherë në javë ni letër e kam dërguar edhe ata m'kanë dërguar ndoshta niherë në javë. Por letra ka zgjatë shumë derisa ka ardhë. S'paku mund të them dy javë, tre javë se shifej data normalisht. Derisa kanë ardhë letrat. Se ka pasur kontrollë normalisht edhe nga edhe këndej në Kosovë në Jugosllavi edhe në Shqipëri. Me siguri janë kontrollu, janë lexu. Nuk e di. Janë vonuar shumë letrat. Në telefon nuk kam folur kurrë. Niherë kemi tentuar që m'ka thirrë im atë nuk është dëgjuar. Se ka qenë lidhja Prishtinë Beograd. Nuk ka qenë lidhje direkte dhe ato në postë. Tentum dhe nuk mundëm me folë.

Kurrë nuk kam folur në telefon. Atëherë s'ka patur video, kështu vetëm me foto. Pave edhe shumë foto që kisha, vetëm në këtë formë kemi komunikuar me letra, asgjë tjetër edhe me telegrame. Kam përfundu ni provim e dija se këta gëzoheshin, shkruja thojsha, "Mbarova provimin, dhashë provimin". Ju bëja telegram për ma shpejt. Ose "Mbarova vitin e parë", ose të dytë ose të tretë dhe ju tregoja në këtë formë. Po.

Anita Susuri: Po po m'intereson edhe fillimisht kur keni shku çka keni bisedu me ta? A ju keni tregu që jeni e interesune me studiu?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Po, po krejt shumë sinqerisht. Të gjitha. E kujt jam, jam pytur, "Kënd e ke patur gjysh? Kënd e ke patur... kënd e ki baba? Me kënd ke patur shoqëri?" Të gjitha, të gjitha, të gjitha

gjanat. Edhe për familjen e gjërë kanë dashur të dijnë. Kënd e kemi, kush është i shkolluar, kush, “A punon dikush në polici, a ka punu në UDB?” Të gjitha këto kanë dashur m’i ditë, të gjitha. Normalisht aq sa... kam qenë e re, aq sa kam ditë. Po kryesisht ju ka interesuar për njerëzit e shkolluar, për profesorët e mi t’cilët i kam pasë, me emra. Për familjarët e largët e krejt këto.

Se ata, thashë, ata... edhe tjerë kanë ardhë përveç ktyne kosovarëve që çka ishin të sigurimit na kanë pytë po kryesisht me këta. Këta kanë qenë burra shumë, shumë, shumë patriot. Unë nuk di që kanë bërë ndonjë të keqe ata njerëz. Njëri ka vdekë në ‘84-ten ka patur sulm diku. Ndërsa Shaban Braha pas viteve të ‘90-ta. Po nuk jam takuar kurrë me ta.

Anita Susuri: Pastaj m’tregut për jetën si studente. Po m’intereson tash edhe për jetën kulturore si studente në Vlorë? Për aktivitetet?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Po shiko, neve... ka qenë shumë interesant me i thanë dikujt ndoshta është e pa besueshme. Konvikti ka qenë... territori i konviktit, oborri ka qenë shumë i madh. Ndoshta mund të them, s’di me tregu sa. Sepse ka qenë rregull në orën 05:30 të mëngjesit ka ra zilja edhe jemi ngritë krejt shkolla. Djemtë edhe vajzat. I kemi bërë ushtrimet e mëngjesit, gjimnastikë. Kemi vrapu, kemi bo ushtrime të ndryshme. Kemi patur ato për t’u... ka patur disa të metalit s’di çka kanë qenë ato s’më kujtohen se kanë kalu shumë vite.

Bënim ni orë ushtrime mandej ktheheshim në konvikt, pastroheshim dhe bëheshim gati shkonim në mensë. Nga mensa rreshtoheshim shkonim, hynim në mësim. Në mësim zakonisht deri në orën 01:30-02:00 se fillonte mësimi në orën 08:00 edhe ktheheshim në mensë hanim drekën. Hynim në konvikt derisa pastroheshim përsëri dhe pastaj nga ora 04:00 deri në orën 08:00 përsëri në shkollë, çdo ditë. Atje na nuk kemi mësu në dhomë po kemi pasë mësim të gjitha i kemi kry detyrat në klasë.

Por, vetëm një herë në javë kemi pasë liri dalje në qytet. Në mënyrë të pa organizuar vetëm ni herë në javë. Nga ora 02:00 deri në ora 06:00 masdite të dielave. Tjera ditë kur na ato të dielën se s’kemi pasë ndonjë aksion ose diçka. Nuk ke patur të drejtë të dalësh jashtë konviktit. Nëse ke dalë jashtë shkollës je përgjegjë para drejtorisë, para ashtu... nuk ka ekzistë. Ka qenë ky rregull edhe për vajza edhe për djem. Vetëm ni herë në javë. Se kemi qenë të ri edhe thjeshtë na ka rujtë shkolla. Na ka rujtë moralin, na ka rujtë që të jemi ma të kujdesshëm për vetvetën. Mos t’i harrojmë mësimet, të mirremi me mësimet jo me gjëra tjera se kemi qenë të gjithë nën moshën 18 vjeçe. Kështu ishte rregulli.

Ndërsa në universitet mandej ka ndodhë ndryshe. Ke patur ma liri dalje. Deri në orën 10:00 kanë qenë konviktet e hapura ke mujtë me dalë kur të dush. Ke mbajtë përgjegjësi ti për vete. Por edhe shteti normalisht i ka shiku ato gjana. E për jetën kulturore ka patur në Vlorë. Ka qenë estrada, ka qenë teatri, ka qenë ansambli, ka pasë pallat të sportit. Teatri bile ka qenë shumë afër shkollës po neve na ka çu shkolla në mënyrë të organizuar. Nuk kemi mujtë me shku vet, “çu vet shko në teatër” po shkolla e ka organizu ose me shkollë ose me klasë ose me grupe.

Në teatër, në koncerte të ndryshme ka qenë shumë e organizuar. Këngëtarët ma të mirë kanë qenë pothuajse vlonjat se ka qenë ajo muzika labe e tyre që ka qenë. Po teatri ka qenë shumë, shumë i zhvilluar. Kemi shku në kinema po në mënyrë të organizuar. Kurrë kështu të pa organizuar. Kështu ishte jeta.

Anita Susuri: A keni ndonjë kujtim kështu ndonjë ngjarje interesante?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Po mendon gjatë shkollimit?

Anita Susuri: Po, po.

Ferdeze Mujaj Sadiku: Diçka nuk më kujtohet, diçka ma e veçantë. Janë sjellë shumë mirë thashë edhe profesorët edhe krejt. Të gjithë m'kanë njoftë si kosovarja, kosovarja por nuk kam diçka. Mbaj mend alarmin e parë kur është... kisha ndoshta nja ni javë që fillova shkollën edhe nga ora 02:00 e natës ranë ato sinjali *pip, pip, pip* {onomotope}. Unë s'dija çfarë është alarmi. Ajo ishte pregaditje për... edhe po i shof shoqet u ngritën sa ma shpejt t'cila përgaditet ma herët t'vishet edhe t'dalin jashtë. I morën çantat edhe kemi patur ato karabinat. Unë ende s'e pata marrë atë... karabina ka qenë pushkë. Pushkë me tre fishek. I morën në krah.

Se ka qenë ajo salla që janë vendosë armët por nuk kam qenë me plumb domethanë vetëm pa. Komplet arma pa fishek. I morën ato në krah, çantat. Çantat e marshimit. Në orën 02:00 të natës na kanë ngritë. Unë mbeta fillova me qajtë, u bë luftë. T'u mendu që luftë. Se s'ma merrte menja që ka aso alarmi që bën në shkollë në orën 02:00 të natës. Ato m'thoshin, "Shpejt shpejt", thosha, "O' luftë", "Shpejt", ato shoqet, "shpejt Ferdeze, shpejt". U bëm gati dolëm jashtë. Mandej na çun kemi ecur deri lartë në Kaninë. Është ajo Kanina është kodra në Vlorë.

Me thanë deri në orën 05:00 të mëngjesit. Nja tre-katër orë kemi ecë në marshim kush, marshim i thojshim, kush po ecë ma shpejt edhe kush po del i pari si ushtar. Ka qenë kjo në '70-ten me siguri kah 27 dhatori. Edhe ishte ftohtë, shumë ftohtë ishte. Meqenëse temperaturat në Vlorë janë pak ma të larta se vend bregdetar. Kjo m'bën përshtypje. S'mbaj mend diçka ma, diçka ndonjë rast s'po m'kujtohet. Ndoshta kam pasur po vërtetë s'po m'kujtohet.

Anita Susuri: Thatë që ju kanë pranuar shumë mirë si kosovare...

Ferdeze Mujaj Sadiku: Shumë.

Anita Susuri: Si ka qenë për ata? A ju ka interesu...

Ferdeze Mujaj Sadiku: Po ata ju ka interesu normal si është jeta në Kosovë, si është në Jugosllavi. Por e kanë patur atë... më porositën njerëzit e sigurimit sa ndejta në Laç që nuk ka nevojë me folë shumë për jetën këtu, kjo është e vërtetë. Trego për familjen tande, trego për vetën por jo a është mirë a është keq në Jugosllavi. Nuk është dashtë t'foli, nuk është dashtë t'bëjmë ato biseda të, që nuk i ka, që me lakmu diçka rinia për këtu. Nuk edhe nuk kanë pytë. Sepse edhe ata kanë patur kujdes, kanë patur kujdes.

Për shembull e kam patur ni shoqe që ma kanë caktu, sot e kom akoma shoqe që vjen te une edhe shkoj, ni Valentina Hoxha. Ka qenë nxënësja ma e mirë e klasës, kryetare e klasës. Kryesisht fillimisht me të, ajo m'ka ndihmu edhe për, për ato provimet që u dashtë unë edhe ni herë t'hy në provime të tjera që ktu nuk i kam pasë disa landë. Nuk kam pasë diçka ndonjë averzion përkundrazi, thashë, më kanë, më kanë respektu shumë. Besoni që shumë më kanë respektu. Kurrë diçka ndonjë ofendim ose diçka kurrë në jetën time nuk e kam pasë, prej shoqeve flas as prej shokëve. Kurrë. Diqysh ka qenë jeta shumë, si them, jetë kolektive, jetë kolektive.

Anita Susuri: M'tregut kur është bo ajo monumenti përkujtimor.

Ferdeze Mujaj Sadiku: Po në '72-shin. Mbaj mend dolëm shkolla normal, na u dashtë me dalë krejt Vlora, krejt nxanësat, krejt shkolla studentat çka kanë qenë. Dolëm në shesh të flamurit erdh mandej udhëheqja prej Tiranës. Normal edhe ish Enver Hoxha normalisht. Ata studentat. nxënësit e tjerë të gjithë duartrokisnin unë qaja, m'shkonin lotët. Diqysh m'pytën, "Pse qan? Në vend se të gëzohesh ti qan". Njerëzve që ishin aty, shoqeve, ju tregova, "Kisha dashtë që krejt Kosova të ishte sot këtu që ta shohin".

Se kështu ishte në atë kohë. Ai ishte idhulli i shqiptarëve të Kosovës. Tash nuk është e hijshme të flas unë për këto gjana tani po unë flas për atë kohë, nuk flas për këtë kohë. Ai ishte ni person idhull që ne mendonim se ai do ta shliroj Kosovën, ai do t'na bashkoj me Shqipërinë. Ashtu ishin pretendimet. Edhe të tij kanë qenë tjetër a ka mujtë me realizu, a s'ka mujtë me realizu. Thashë, unë qaja, m'shkonin lot sikur... vetëm sa s'qaja me za të lartë po lotët po. Se doja që krejt Kosova, kisha dëshirë, thojsha, "Sikur të ishin ata këtu".

Anita Susuri: A ka pasë dëshirë edhe dikush prej familjes t'juj ose a keni pasë ju dëshirë me marrë me ardhë vëllau ose motra?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Po, ka ardhë nana në '74-ten isha studente me vëllaun e vogël, ishte katër vjeç. Vetëm nana ka ardhë ka nejt ni muaj. Kemi nejt në hotel sepse s'kam pasë banesë, nuk kam pasë. Në konvikt nuk ka mujtë me nejt nana. Ka ardhë mandej në '78-ten baba me nanën edhe me atë vëllaun. Atëherë kur është im atë ka ardhë dhe ka bërë kërkesën për t'më kthy mu në Kosovë.

Mandej m'u leju mbas, i bie, në tetor të '78-tes është bërë kërkesa në qershor të '79-tes unë u ktheva. Domethënë gati ni vit, pas ni viti. Derisa e pranoj Jugosllavia fillimisht mandej edhe Shqipëria. Se ni herë u dashtë me marrë vizën jugosllave mandej me marrë edhe atë të Shqipërisë.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Domethanë pas perfundimit të studimeve thatë që keni punu në Tiranë...

Ferdeze Mujaj Sadiku: Po, po. Mbarova fakultetin. Në atë kohë ka qenë kur sapo e ke përfundu fakultetin, të gjithë studentat, nuk ka patur nevojë me shku me kërkunë kërkund. Automatikisht ka dalë emri në Komitetin Ekzekutiv, lista ka dalë jashtë. Kemi shku diku, jashtë, në ato koridoret e asi... mu m'del emri për në Berat. U caktova në Berat me punu. Në përgjithësi ni pjesë e madhe e kosovarëve në atë kohë i kanë dërgu në Berat, nuk e di arsyen pse.

Unë mandej u ankova, bëra ni kërkesë në Ministrinë e Arsimit edhe në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Si kërkesë thashë, "Unë jam vet, e kam kriju këtu shoqërinë, e kam krijuar këtu rrethin, do ta kem vështirë vajzë me shku tani në Berat. Ku do t'rrijë?" Këtu bile isha në konvikt. Jetoja në konvikt. Se në atë kohë edhe vajzat e tjera të cilat nuk kanë qenë tiranëse nga Tirana domethanë disa aktore, këngëtare kemi jetu në konviktin numër 18.

Kanë qenë studentet e huaja që nuk kanë qenë shqiptarë, vietnameze, kineze. Ka patur koreane, ka patur nga Jemeni arabe, palestineze. Kanë jetu në qytetin e studentëve në konviktin numër 18. Aty isha. Faktikisht unë diplomova me 24 gusht '78 se ni vit ishte stazh pastaj diplomoje. Punën e fillova me 20 tetor domethanë dy muj e diçka mbeta pa punë derisa m'u aprovu dhe fillova punën në farmacinë kryesore të Tiranës, farmacia numër ni. Ishte...

Anita Susuri: Jeni vendosë edhe në Tiranë?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Jo në Tiranë mandej kom vazhdu deri ditën e fundit sa kom ardhë në Kosovë kam jetu në konvikt. Prej konviktit jam kthi në Kosovë. Në qat' konvikt kam patur një dhomë e një studente tjetër rrija aty. Kështu që shkoja çdo ditë në punë dhe kthehesha.

Anita Susuri: Jeta në Tiranë si ka qenë?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Jeta në Tiranë ka qenë e mirë, shumë e mirë. Ka patur art shumë, ka patur opera, ka patur balet, ka patur estradë. Mos të flas për teatër, për filma, për... ka qenë e mbushur me aktivitete shumë të mira për shembull. Ansambli i shtetit ka qenë në Tiranë pothuajse çdo javë ka patur koncert. Ka patur filma shumë të mirë kryesisht italian, kryesisht italian dhe françez. Tash nuk

më kujtohen cilët po këta filma kanë qenë më tepër. Estrada ka qenë shumë në nivel teatri normalisht. Ka qenë jetë e organizune.

Kemi pasur pothuajse çdo mramje ke patur ku të shkosh. Jo nëpër kafene si tani, ka patur edhe atëherë kafene, po kryesisht kanë shku më tepër meshkuj ose familjar. Burrat kanë qenë të martuar. Na vajzat ma tepër ju kemi shmang atyre. Jo për diçka po ma shumë jemi shmangur. S'ka patur si tani këto qysh janë tani. Po kemi shku nëpër këto, për shembull, opera. Sot e asaj dite kam dëshirë me dëgju operat. E ndjej atë, e përjetoj. Sepse ka patur vërtetë kuadro shumë të mira. Ka patur tenor të jashtëzakonshëm. Avni Mula është një për shembull më të mirtë. Babai i Inva Mulës, ai kosovar është gjakovar me origjinë. Ke patur çfarë të dëgjosh, çfarë të shohësh. Mandej televizioni ka patur, ka patur emisione edukative kështu që...

Anita Susuri: E deshta me ju pytë edhe a keni pasë kontakt me ndonjë shqiptarë tjetër të Kosovës aty?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Po ka patur, plot ka patur për shembull, kam shku në shtëpinë e Adem Istrefit, ka qenë ni poet shumë i mirë i rangut ndoshta të Agim Gjakovës. Kam njoftë edhe grujën e tij, ka pasë banesën afër konviktit, kam shku disa herë. Ka qenë ni Bajram Sadiku me familje. Me këta kryesisht. Kanë qenë ma të vjetër se unë po familjar. Kam shku te këta. Tjertë nuk ka pasur tjertë që unë i kam njoftë. Se pak kanë jetu në Tiranë, kanë qenë në rrethe të ndryshme zakonisht.

Për shembull në fakultet nuk ka pasë, në fakultet të mjekësisë nuk ka pasë asnjë kosovar nuk ka qenë. Kryesisht kosovar që kanë shku kanë qenë histori, gjeografi, kanë qenë gjuhë letërsi, në qito degët. E në mjekësi nuk ka patur kurrë, në kohën që unë isha. Se thashë nga '68-ta deri në '79-ten nuk ka patur kosovar, nuk kanë pranua ma. Kanë ardhë po i kanë kthy meniherë. I kanë majtë në Laç dy-tre muj edhe i kanë kthy mbas.

Anita Susuri: E a keni vretë ndoshta që prapë ju kanë përgju ose ju kanë...

Ferdeze Mujaj Sadiku: Dëgjo, unë po them, unë kom qenë vajzë nuk e di, kam qenë e re, ndoshta më kanë përgju. Unë nuk kam ditë t'i vrej a m'kanë përgju, me siguri m'kanë përgju. Po unë nuk kam ditë, nuk kam vretë ndoshta. Edhe shoqja ma e afërt e imja ka mujtë me qenë përgjuese ose thjeshtë m'ka përcjellë ku shkoj, çfarë them, ndoshta. Por unë nuk kam mujtë me vretë. Ndoshta kam qenë e pa djallëzuar në atë drejtim edhe nuk m'ka shku mendja kurrë. Po është e vërtetë që kam qenë e kujdesshme. Nuk kam folur kurrë diçka çka e kam kuptu që nuk duhet të flasësh. Nuk kam bërë ndonjë lavdatë për këto ose ato. Ato kanë qenë gjëra që të kanë qujtë sikur propagandë, po bën propagandë armiqësore për shembull.

Unë ju kam rujtë atyne gjërave, prandaj kam shpëtuar ndoshta prej atyne gjërave. Megjithatë e thashë, sidoqoftë, unë jam falënderuese për gjithçka. Ai shtet mu nuk m'ka thirrë të shkoj, të thashë edhe atë ditë, unë kam shkuar vet. Faktikisht më kanë shkollu sikur me i pasë pasur prind. Faktikisht sikur me

ushqim, me veshje... s'osht' puna vetëm te interesi por ni dikush që të mban nuk duhesh ta shkelësh, në këtë kuptim po them. Nuk di. Faktikisht nuk mund të... kam qenë e re për ato gjana. E re, ndoshta 25 vjeçe kur jam kthy nuk kam qenë shumë e re po thjeshtë nuk më ka interesu politika. Unë kam dashtë me kry shkollën time, jam punësu.

Nuk e kam ditë që do të kthehem ndonjëherë se ka qenë shumë edhe ajo forma kur m'kanë kërku të kthehem ka qenë rrezik, se ka mujtë mos me m'kthy ndoshta do t'më kishin internu qysh ka pasë plot raste që osht' folë. Kësaj ju kom frikësu shumë. Po vendosa, thashë, bëhet çka të bëhet të kthehem në familjen time se ata kanë nevojë thjeshtë t'më ken' afër.

Anita Susuri: Më tregut edhe pak për sigurinë që e keni ndje atje edhe që ka qenë shumë e sigurt për çelësa për... nëse mundeni...

Ferdeze Mujaj Sadiku: Po, po thashë, jeta ka qenë shumë e sigurtë. Të tregova. Ke mujtë me hecë natën ku të dush si vajzë, si djalë, si... nuk ka guxu, flas për Tiranë, për aty ku unë kam jetu. Për atë maj përgjegjësi. Nuk ka guxu kush jo me të prekë po as me të ofendu. Ka mujtë për shembull dikush me thanë, "A muj me bisedu me ty?" Absolutisht po. Ke dashtë je ndalë, s'ke dashtë ke ecë rrugës tande. Kjo nuk t'ka ndodhë kurrë. Sado, kushdo që kishe qenë ti ose ai person. Shkollimi ka qenë jashtëzakonisht në nivel. Të tregova domethanë, nuk ke patur aty je e bija e dikujt, je i biri i dikujt, je ashtu, e ki babën profesor, e ki doktor. Ato s'kanë ekzistu.

Unë privatisht i tregova edhe disa raste që mu m'kanë bërë përshtypje. Sot i diskutoj. Vetëm në rastin tim çfarë njerëz, çfarë shoqe të mia që s'kanë fitu të drejtën e studimit, që e kanë humb vitin ashtu edhe pse kanë qenë bijë ose bija të njerëzve shumë të mëdhej. Domethënë në atë kohë ashtu ka ndodhë. Siguria ka qenë në nivel, thashë, nëntë vite kam jetu kurrë vrasje nuk kam dëgju, kurrë, kurrë, kurrë. Se do të ishte marrë vesh u vra midis qytetit dikush si tani, do shifej. Nuk ka ekzistu kurrë. Domethanë as dhunime, as vjedhje të hapura nuk kam dëgju. Nuk ka ekzistu, të tregova çelës në konvikt. Në konvikt nuk ka ekzistu çelës as në dollap, as në dhomë, as në hyrje të konviktit. Kurrë. Vet konviktet kanë qenë. Ka qenë rrinte ni kujdestare poshtë, në hyrje të konviktit edhe aq.

Ushqimi, flas, në kohën kur kam jetu nuk ka qenë ajo kriza që është përjetu më vonë, flas për Tiranë. Nuk e kemi ndjerë mungesën e ushqimeve që flitet më vonë. Unë mungesën e frutave, mungesën e mishit, mungesën e bukës nashta ka pasë disa sene lluks që kanë mungu por në përgjithësi nuk e kemi përjetu. Unë nuk kam parë diçka të tillë.

Anita Susuri: E ju thatë që keni pasë edhe pak pare për veti, a i keni shfrytëzu për me dalë me ble diçka? Për veshje?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Po, po. Për shembull të tregova bursat normale të qytetarëve të studentëve të Shqipërisë kanë qenë me ato lekët e atëhershit 3000 lek në muaj. 2500 lek mesa më kujtohet ka qenë

ushqimi dhe fjehta dhe të gjitha 500 lek iu kanë mbetë studentëve për libra, për fletore, për t'pasë pare kështu. Ndërsa unë si kosovare e kam pasë bursen 4800 lek, 2500 lek ka qenë për konviktin ato, tjerat i kam patur për harxhime tjera meqenëse kam qenë pa familje.

Por edhe plus shteti t'i ka pagu librat, fletoret në fillim kur ka fillu fakulteti të gjitha m'i ka ble, m'i ka pru. Konvikti aty. Nuk kam patur ndonjë problem ekonomik, absolutisht. Jo veç unë po të gjithë kosovarët të njejtën bursë e kena pasë, sa ka pasë në atë kohë. Kështu që nuk... edhe studentat e Shqipërisë e kanë pasë nifar' jete ma normale. Të gjithë kanë qenë me bursa, nuk i ka mbajtë familja. Pothuajse 90 përqind kanë qenë me bursa, ndoshta një 10% s'ka patur bursë, i kanë patur kushtet ndoshta pak më mirë familjare.

Anita Susuri: Që ishim duke bisedu për dëshirën për m'u kthy te familja, a e keni shpreh këto në letra babait ose...

Ferdeze Mujaj Sadiku: Jo, jo në asni mënyrë. Këto gjana nuk janë shkrujtë. Në letra jemi mirë, dhashë ni provim, jam me shëndet mirë, jam në aksion, në ushtri nuk është përmend ushtria domethanë ato ushtrimet ushtarake. Jam në pushim në deti, ju si jeni? Mos u bëni merak, gjithçka është në rregull, gjithçka është mirë, këto gjana. Ose me shpreh ndonjë dashuri prindit ose nanës ose diçka ndonjë varg i bukur, ndonjë poezi, ndonjë diçka të tillë se kurgjo tjetër politike çka ka anej kurgjo hiç.

Anita Susuri: Më tregut pastaj që kanë ardhë prindërit.

Ferdeze Mujaj Sadiku: Po, thashë, në '78-ten. Babain e pashë mbas tetë vjetësh, nuk e kam parë kurrë. Nëna ka ardhë edhe niherë tjetër. Faktikisht dy herë nana ka ardhë, babai ka ardhë vetëm niherë. Mbas tetë vjetësh e kam pa babain. Ndërsa motrat e vëllezërit i kam pa pas nëntë vitesh. Nuk i njoha kur i pashë sepse i lash fëmijë. Motrën e madhe e lash njëmbëdhjetë vjeçe e gjeta 18 vjeçe, 19. Faktikisht ajo kishte ndryshuar komplet. Ta kisha pa dikund tjetër në rrugë s'do e kisha njohur, as vëllezërit e tjerë. Mos të flas për familjart e tjerë se nëntë vite ishin shumë.

Fotografi kisha veç të ktyne fëmive të motrave, vëllezërve e tjetër nuk i kisha të tjetër. Ka qenë ni mall shumë i madh. Nuk e kam ditë që do të kthehesha, ta kisha ditë nuk isha mërzit shumë se thashë do i kisha numëru ditët, muajt dhe vitet dhe kishin kalu pak më lehtë a kështu pak ma vështirë ka qenë. Se shpresë nuk kam pasë pothuajse fare. Ishin kohë të tilla që nuk guxojë ta kërkojë të thojë unë do kthehem. Ata nuk thonin Kosovë po thonin Jugosllavi. Kështu që kjo ishte pak ma e ndishme.

Anita Susuri: E si erdhi që u aprovu kërkesa juj'?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Nuk di, as vet nuk e di të të them. Këtu është bo kërkesa. Mbaj mend kur shkova në Ambasadën Jugosllave masi mora vesh që m'u leju. Shkova në ambasadën, jo, kur u bë kërkesa shkova në Ambasadën Jugosllave u desht normalisht me i lajmëru policinë që unë po shkoj në

Ambasadën Jugosllave. Ai ambasadori jugosllav, nuk më kujtohet emri, e di që ka qenë m'dukët malazez qysh më thanë. Tha, "Në asni mënyrë", tha, "kjo është shkollu këtu, është eduku me idetë e ktij Enver Hoxhës", tha, "nuk guxon. Ni vjet dy kanë me kalu do të arrestohet", tha, "kjo atje".

Mandej qëlloj aty ni sekretar i parë i ambasadorit, ni shqiptar i Malit të Zi, ni Prenk Lulgjuraj. Ni person shumë pozitiv në atë kohë edhe e di që i tha ambasadorit serbisht i tha që, "Kjo ka qenë shumë e re kur ka ardhë, kjo ka kry fakultet të mjekësisë nuk ka ndonjë fakultet për shembull të gjuhës, mësuse që do të punoj në Kosovë. Kjo do t'punoj me ni vend që nuk ka kontakte me..." është më ndryshe kanë qenë më të ndjeshme ato lloj shkollash. "Ka qenë shumë e re, ka qenë fëmi dhe do të kthehet", "Jo nuk ka mundësi". Po mandej është rregullu.

Kanë shiku mandej, nuk e di qysh ka ndodhë. E kanë pa që unë kam shku shumë e re edhe u aprovu. Thashë mas tetë-nantë muajve mesa di. Aty në Shqipëri veç e lejuan edhe kështu. Nuk di edhe vet pse ka ndodhë, fati ndoshta, fati.

Anita Susuri: E di jeni ndje pastaj kur keni marrë rrugën për m'u kthy e krejt?

Ferdeze Mujaj Sadiku: M'kanë pritë... e kam bo telegramin dhe kam dalë me taksi në Han të Hotit në Mal të Zi. Kanë ardhë m'kanë pritë tre xhaxhallarët, daja me gru me djalë, vajzat e axhës. Atje në kufi. E di me tre vetura kanë ardhë më kanë pritë. Nana, babai im dhe vëllau. Sapo... t'u e kalu kufirin im vëlla, Naimi, ka qenë në atë kohë shumë e popullarizune kënga e Shkurte Fejzës "Erdha nga qyteti" në fshat të jetoj. Atë kangë, besoni, ushtojke, se ka qenë Liqeni i Shkodrës aty afër, ushtojke mali. Unë u çudita qysh ka guxu po ky ka qenë shumë i ri, ka qenë 16-17 vjeç në atë kohë në atë vit.

E ka lëshu atë kangën me kasetë domethanë në veturë me ni za shumë të lartë. Ma kushtonte mu që unë po vi nga qyteti në fshat të jetoj dhe ishte pak kangë shumë e dëgjuar në atë kohë. Shkurte Fejza si sot e asaj dite ka mbetë ajo këngëtare që ka qenë. Nuk reagon ata. U përshëndeta me ata të Shqipërisë që ken aty kufitarët, dola këndej. U përqafova me të gjithë këta njerëzit e mi. Mandej kur ni natë ndejtëm këtu në Prishtinë e kisha tezën se u lodhëm shumë, rruga e gjatë. Nuk ishte kjo rrugë siç është tani. Atë natë tani kemi shku në "Hotel Grand" ka qenë ni këngëtare shumë e njohur.

Këndonte ni kangë Elbasan i bukur. Se e mori vesh që unë erdha nga Shqipëria. Ishte ajo koha '79 ende ishte koha pak ma liberale në Kosovë. Se mbas '81-shit masnej u dëmtua shumë, domethënë u shkatërru. Faktikisht filloj shkatërrimi i Kosovës. E të nesërmen të asaj dite u nisëm për në fshat. Kanë dalë njerëzit, ne i themi Shipashnicë e Poshtme. Deri në Shipashnicë të Poshtme kanë dëgju edhe pse nuk kanë tregu prindërit e mi që do vijë vajza, po nuk e di, fjalë mas fjale qysh kanë dëgju pothuajse i tërë fshati kanë dalë edhe m'kanë pritë.

Është... mundeni me pytë. I tërë fshati kanë dalë. E kanë lënë punën nëpër ara, ka qenë qershori, oborri... m'kanë marrë në krah se s'kanë mujt me hy nga njerëzit. Mandej kanë ardhë aq shumë njerëz

m'u taku pastaj për çdo ditë, për çdo ditë. Shumë interesant se do ta gjej do ta dërgoj atë dokumentin. Çdo person që ka ardhë në shpi të babit tim ishte regjistru dhe e kishin dërgu në sekretariat në atë kohë ka qenë. Pas ni jave që erdha ose dhjetë dite m'thirren pastaj në SUP² në UDB të Gilanit. Tre javë kam qenë në pyetje për çdo ditë, për çdo ditë, për çdo ditë. Nga ora 07:00 e mëngjesit deri në orën 06:00 të mbrëmjes.

Nuk kam pasë dhunë fizike veç psiqike, më fal, derisa fillun të vjellurat. Nuk e di çfarë m'dhanë diçka me pi, dyshoj, ndoshta jo por dyshoj. Mbas tre javësh ata... njëri deri vonë ka qenë gjallë, i kam njoftë ata persona që m'kanë marrë në pyetje. M'tha, "Ti nuk do vish ma këtu se po t'shohin njerëzit po na e kemi", tha, "ni shtëpi private, do vish atje", edhe unë i thashë, "Kurrë. Këtu është institucion jam e detyruar, nëpër shtëpia private nuk vi kurrë". Pse do shkoj unë në shpia? Se këtu po të shofin njerëzit që ti po vjen e tana... unë nuk po vi vet, ju po më thrrisni, unë jam e detyruar t'vi jo që po du vet t'vijë, çka kam patur punë unë aty.

Ata dinin gjithçka. M'beso dinin edhe lëvizjet ma të thjeshta t'miat në Shqipëri, të gjitha i dinin. Edhe shoqet e mia, ni pjesë e madhe e shoqeve të mia i dinin që unë kam pasë, kënd e kam pasë shoqe, kënd e kam patur shok. Me emra, më besoni, me emra e dinin gjithçka, gjithçka, gjithçka. Hynin, dilshin njerëzit aty veç shikonin çka po ndodhë. Edhe sot e asaj dite unë nuk e kam nënshkru deklaratën edhe shumë kam pasur qef ta gjej atë deklaratë. Nuk e kam nënshkru se ata e kanë shkrujt vet edhe e kanë kërku me nënshkru. Unë nuk e kam nënshkru. Për këta a din jom kështu plotësisht e sigurt edhe e di, m'u gjetë dikund dije që unë nuk e kam nënshkru atë, nëse është dikund nëpër arhiva të sekretariatit që i kanë thanë përpara të punëve të brendshme në Gilan. Nuk e kam nënshkru.

Mandej vazhdimisht kanë ardhë. Edhe në punë masi kom fillu kanë ardhë në punë edhe më kanë kërku me folë me ta. S'kam pranë, "S'du me folë, s'kam çka flas me juve". Në '91-shin përsëri m'kanë marrë në pyetje ni shqiptar edhe dy serbë. Më kanë nxerr prej punës edhe m'kanë marrë në pyetje. "Ti je kanë në Shqipëri, mujna mos me t'lanë me punu". Unë u pregadita në '91-shin thashë im shoq thashë, "Po shkojna dikund jashtë se s'na lojnë me punu". Po mandej ndryshun senet, filloj privatizimi edhe qishtu. Nuk ka qenë... gjithmonë kam qenë... për shembull në pasaportë mu m'kanë dhanë në '87-ten. Mas, sa po i bjen? Mas tetë vjetësh. Tetë vjet.

Çdo herë kur kom kërku pasaportën kur donim me shku në Greqi ose dikund në deti. Thojshin, "Është kontestuese". Shkonte burri jem me kërku, "Është kontestuese". Kërkova në Gilan nuk m'dhanë, kërkova në Prishtinë, nuk m'dhanë. Në '88-ten domethanë unë e kam marrë mbas nantë vjete po i bjen, '87-ten më fal, pas tetë vjete e kam marrë pasaportën. Pasaportën, ato pasaportat që kishim mundësi me dalë jashtë Kosovës për shembull, jashtë Jugosllavisë.

Anita Susuri: E ju u punësut pastaj...

² Ministria e Punëve të Brendshme e Jugosllavisë.

Ferdeze Mujaj Sadiku: Jo u punësova unë në gusht, me 1 gusht. Aty thjeshtë ka qenë në atë kohë, i gjetëm disa njerëz që i njifshim. Ka qenë si rang ministri i punëve, rang të ministrit të shëndetësisë ka qenë ni doktor Mehmet Begraca. Ni njeri shumë patriot në atë kohë, njeri që ka punu shumë, njeri shumë... thjeshtë komunikues me njerëz. Na dërgoj dikush, i çova unë diplomën, i çova dokumentat. Çova gjithçka edhe komplet atë orarin që kisha patur të krejt gjatë universitetit. Ai vetëm i pa i tha atij personit, vetëm ia dha ni letër të bardhë. Ai shkollën tetë vjeçare e kishte kry në Lushnje, ky, Mehmet Begraca. Ka ndrru jetë.

Tha, “Shkruj çfarë të duash”. E shkrujtëm na aty, e shkrujti ni lutje ma tepër për me shku m’u lajmëru në drejtorinë e barnatorëve të Prishtinës. Shkum aty, hezitun ata shumë. Plan programin e panë krejt ishte, përputhej komplet me këta, plan programin e Universitetit të Beogradit. Se këta në përgjithësi farmacistat e Kosovës në atë kohë janë shkollu jashtë. Nuk ka pasë universitet, nuk ka pasë degë të farmacisë në Kosovë mas viteve ‘90-ta dikur kur është hapë. Që kanë qenë... nuk ka qenë tamam universitet po nëpër shtëpia private. Pas luftës mandej... ata hezitun mandej normalisht po ishte mungesë shumë e madhe e kuadrit, nuk kishte farmacista.

Në Prishtinë ka qenë veç gruaja e Esat Stavileci para meje, profesorit Esat Stavileci. Ka qenë edhe ni tjetër ka mbaru në Beograd Minire Marku edhe s’ka patur tjera shqiptare. Nuk ka patur farmaciste vetëm serbe. Po edhe serb ka pasë mungesë se mungesë kuadri. Tri barnatore i ka pasë Prishtina. Derisa Tirana në atë kohë i ka pasë 13 barnatore Prishtina i ka patur tri kur unë kam fillu punën në ‘79-ten. U punësova tani aty si kuadër deficitar edhe vazhdova punën deri sot ma.

Anita Susuri: E po du me ju pytë pak edhe për do ngjarje këtu që kanë ndodhë pastaj pasi jeni kthy në Kosovë. Ka qenë ‘81-ta...

Ferdeze Mujaj Sadiku: Po ‘81-shi ka qenë, po, e mbaj mend mirë. Unë kam qenë t’u punu në Obiliq edhe në Obiliq pat’ demonstrata. Unë... nuk munden me ardhë këta të Prishtinës, të kombësisë tjetër, dy punëtorë tjerë në Obiliq. Mu më caktun në Obiliq pastaj sepse asnjë farmacist nuk ka pranë me shku në Obiliq me punu, asnji, kanë punu vetëm teknik. M’thanë... meqenëse tjerë s’kanë shku e dinin që unë nuk do të refuzoj. M’thanë, “Ti do shkosh në Obiliq”, thashë, “Po, unë ku ka nevojë atdheu do të shkoj do punoj”. Ishim mësu na atje ku ka nevojë atdheu duhet me shku me punu. M’caktun shkova në Obiliq.

Atje mirë domethanë, kishin barnatore, kishte punë shumë se veç ni barnatore krejt Obiliqi, krejt rrethi i Obiliqit. E ishte fjala te demonstratat. Mbeta unë vet punova prej mëngjesit deri në ora 10:00 të mbramjes sepse kishte, si të plagosur, si të lëndun ata, këta, nxanësat. Nxansa kryesisht aty edhe disa studenta. Ju dhashë do ndihma të thjeshta se normal ato të randat kanë shku nëpër spitale. Mas, po m’thirrë drejtori i, drejtori gjeneral që kena pasë po tregon mas disa kohe kanë shku këta të UDB-së të Prishtinës me pytë ku jam unë. Kanë shku te drejtori.

Thotë, “Fola në telefon, vajza”, thotë, “është në punë në Obiliq që doni shkoni”. Tash a kanë ardhë ata dikush me shiku nuk e di po thjeshtë e kanë pytë drejtorin ku jam unë, mos kam dalë, mos jam edhe unë diku në demonstratë ose në organizim. Jo, në demonstrata nuk kam marrë pjesë, jam mundu... e di që kam qenë e njohur për, si tip që kam jetu në Shqipëri. U dashtë pak m’u rujtë për shkak të familjes, për shkak... thojsha më mirë të shërbej. Kam punu aty ku s’ka pasë kurrë shqiptar në Obiliq. Vinin njerëzit dhe u konsultojshin, jo për ilaqe po vetëm thjeshtë u konsultojshin për ndonjë problem. Sidomos femrat. Se aty ka pasë vetëm disa meshkuj që kanë qenë të nacionalitetit tjetër që kanë punuar.

Anita Susuri: E me bashkëshortin si jeni njoftë?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Bashkëshortin tim unë e kam pasë shok klase këtu në Prishtinë. Kur u ktheva nga Shqipëria mund të them që të gjithë shokët e klasës... se unë kam qenë veç ni vajzë në klasë, krejt djem kanë qenë, vetëm ni vajzë. Krejt shoktë e klasës nuk kanë ardhë me qëllime të caktune po kanë ardhë m’u përshëndet, m’u taku. Sepse ka qenë... isha si rast i veçantë a din, ju ka bërë përshtypje në atë kohë. Shkoj në Shqipëri në atë kohë u kthy e shkollune e çka po di une. Ju ka bërë përshtypje. Kanë ardhë të gjithë. Po ky punonte në Obiliq aty në Institut të Mjekësisë së Punës edhe pothuajse vinte çdo ditë aty në barnatore.

Aty afër ni vajzë që punonte në arkë aty e kishte si kusherirë. Bile unë mendoja që e kishte të dashur këtë vajzën. Vinte vazhdimisht, vazhdimisht t’u u taku, t’u ndejtë. Kur shoqërohesh shumë me dikënd a në fillim pa asni tendencë. Thjeshtë shok. Unë thojsha, “Shok e kom edhe pikë”. Bile thoshte, “Pse s’po martohesh?” Thojsha, “S’kish këtu burrë për mua”, a din (qeshë). Kështu që domethanë ajo t’u shoqëru, t’u ndejtë edhe lindi dashuria.

Sot jam, kam një martesë të jashtëzakonshme, jo sot po prej kur jam me të, beso nuk e di a ekziston ndonjë gru ma e respektune që jam unë prej tij. Jo tani që jam në këtë moshë po prej ditës të parë. Nuk di kështu, idhulli i tij, bile kështu e kuptoj. Edhe fëmijtë i kam shumë të mirë. Asni nanë nuk thotë që fëmijtë i ka të kqi po janë shkollu, janë mirë. Ishalla kanë shëndetin, mirë janë. Të dy kam nipa, kështu që mirë.

Anita Susuri: Deshta me ju pytë se paraprakisht në fakt ju pyta, deri kur keni fillu me punu kështu në barnatoren e ju’ po m’doket thatë në ‘93-shin...

Ferdeze Mujaj Sadiku: ‘93-shin po. Kur është privatizu.

Anita Susuri: Pastaj si ka vazhdu? Kjo ka qenë domethanë burimi financiar për familjen?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Po ky ka qenë... ka punu edhe bashkëshorti akoma. Fëmijtë i kisha të vegjël. Bashkëshorti punonte në punën e vet unë punoja këtu. Deri atëherë punova në barnatore shtetërore

po normalisht u zvogëlu rroga se ishte ai devalvimi i madh i dinarit që ishte. Mandej fillova këtu se veç hynën masat e dhunshme, na larguan prej pune edhe e hapa këtë barnatoren këtu e cila ende funksionon edhe sot, në vitet e '90-ta domethanë. Kanë qenë të tmerrshme veç aty çfarë kam parë unë çfarë ju bënin njerëzve policia, djemve. Ua merrte paratë, i ç'veshte. Ka ndodhë para barnatores kam pa njerëz t'u ia marrë paratë edhe të vjetërve edhe të rinjëve. Kështu komplet. Njëpër xhepa njëpër...

Nuk ka qenë e lehtë. Çdo ditë kemi qenë... jeta nuk ka qenë e sigurt. Çdo ditë thojsha çka do ndodhë sot, çka do ndodhë nesër. Edhe derisa ndodhi lufta, ndodhën bombardimet. Nuk ka qenë e lehtë për asni shqiptar as për neve si familje...

Anita Susuri: Veç t'ju pys edhe ni detaj. Kurrizi është njoftë si ni vend ku ka qenë pak ma si i sigurt për rininë, ajo pjesa e mbyllur...

Ferdeze Mujaj Sadiku: Ajo ishte deri në ni kohë pastaj u hoqën ata, u prishën sepse hynin policia dhe rrafshin, e bënin... faktikisht kishin presion rinia dhe u mbyllën pastaj ato kafiqe që ju thojshin. Ka qenë ni vend janë mbledhë shumë rinia aty. Kanë vallëzu, kanë ndejtë, kanë pasë ato aktivitetet e tyre të vazhdueshme që i kanë bërë në kurriz. Pastaj nga fundi nëse më kujtohet '98-ta ma veç u mbyll ajo nuk ka funksionu në atë mënyrë, nuk kanë ardhë ma të rinjtë sikur përpara. Ikën ni pjesë e rinisë të Prishtinës shkun jo në Angli, shkun jashtë. Faktikisht u degradu ai vend pastaj për rininë. Fillun pastaj këto shitoret e veshmbathjes e çka di unë këto.

Anita Susuri: Çka ju kujtohet për shembull prej... po më doket edhe motra juj' ka qenë aktiviste?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Është marrë pak me politikë po ajo atje në Komunë të Kamenicës.

Anita Susuri: A ju kujtohet ndonjë marsh i grave ose diçka? A keni marrë pjesë?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Po, po. Më kujtohet kemi shku te Ambasada Amerikane aty kam qenë në atë rast. Me sa më kujtohet për këta familja Jashari kur ka ndodhë...

Anita Susuri: Me bukë në dorë që ka qenë?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Po diçka e tillë, diçka e tillë ka qenë kur kemi shku te Ambasada Amerikane. Thjeshtë ni protestë në Arbëri që ka qenë ambasada, aty kam qenë niherë.

Anita Susuri: Ju veç keni marrë pjesë?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Po, po vetëm kam marrë pjesë, vetëm kam marrë pjesë. Nuk kam bërë diçka tjetër vetëm pjesë kemi marrë.

Anita Susuri: E si ka qenë pastaj '98-ta e '99-ta veç fillimi i luftës në atë kohë?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Ishte e randë shumë, vërtetë ishte e randë. Çdo ditë pritshim që do të bëhet diçka, çdo ditë. Nuk, nuk ka qenë e lehtë. Unë i kisha fëmitë i kisha ende të vegjël. Mbaj mend kanë ardhë policia niherë këtu te dera. Erdhi kah ora 02:00 e natës. Njëni prej atyre personave punonte në Institut të Mjekësisë të Punës që ka qenë dispazeri i mjekësisë së punës në Obiliq. Tash e kishin, ishte lëndu ni polic serb edhe e kanë ditë që unë e kam barnatoren se e kemi pasë emrin aty. Kemi qenë të detyrun, na detyroj policia me qit' numrin e telefonit në xham të barnatores.

Vijnë këtu. Nuk thirrën në telefon po vijnë direkt këtu në derë. I mshon derës *bum, bum, bum* {onomatope} kështu. Thotë, "Hajde me na hapë barnatoren se e kemi ni polic të vram". Unë i thashë, "Jo se i kam fëmitë vet", "A e ki shok burrin?" Po ku guxoj unë në 02:00 të natës të dal me polic. Tash ata kanë mujtë ndoshta edhe me thy derën patjetër. Por njëri nga ata punonte në Institut të Mjekësisë të Punës. Ndoshta ai hezitoi. "Jo t'lutem hajde me hapë barnatoren se i kemi ilaçet".

Nuk jam çu edhe shpesh them qysh guxova mos me shku me hapë barnatoren që domethanë... sepse thotë, "E kemi ni polic të lëndun edhe atje nuk ka barna në spital". Këtë rast e mbaj mend. Tjetër kështu s'kena pasë diçka. Dhunë direkte nuk mund të them po frikë po, patjetër. Kurrë nuk e di çka do... këtë moment je mirë kurrë nuk e ke ditë çka do t'bëhet mbas pesë minutave. Kur kemi pa gjithë atë polici këtu në Dardani t'u ecë e t'u shku.

Anita Susuri: M'thatë edhe për fillimin e bombardimeve edhe për fqinjët që i keni pasë?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Po thashë kemi patur ata, dy polic të vrarë serbë kanë qenë në hyrjen ku unë jetoj. Njëri ka qenë vetëm ni hap, ta tregoj tani kur t'dalim mund ta tregoj edhe banesën e tij. Meniherë është këtu ballë për ballë me mua. Tjetri më poshtë. Njëri është vra në Breg të Diellit mesa di unë nga UÇK-ja, tjetri është vra diku në Rajon të Drenicës. Dytë polic serbë kanë qenë në atë kohë që i kemi patur në hyrje.

Mandej kanë ardhë ata serbët... para bombardimeve kjo ka ndodhë, para bombardimeve domethanë nga fillimi i '99-tes kështu ka qenë diçka. Vishin mandej serb këtu m'i marrë, m'i ngushëllu. Plot ka qenë polici hyrja. Veçse s'kemi guxu, bile shkonim në fshat se s'kemi guxu me ardhë. Unë kam shku te prindët e mi në Kamenicë, i kam marrë fëmitë. S'ke guxu me hy brenda në hyrje se kanë qenë komplet serbë.

Anita Susuri: Zonja Ferdeze, m'thatë që me 11 prill pastaj jeni detyru me lëshu banesën e ju', qysh ka ndodhë krejt kjo nëse mundeni me na tregu?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Dolëm pam edhe disa njerëz tjerë këtu që ishin dalë në oborr që veç tentojshin, ishin bërë gati për t'ikur për Maqedoni normalisht. Në atë kohë për Maqedoni. Ende s'kishin fillu kjo

pjesa e Prishtinës me shku për në Shqipëri ose ende trenat s’kishin fillu me bajtë njerëz. U nisëm ne. Me veturë kalum këndeje ishte plot polici, plot, plot, plot. Shkum te shkolla mjekësore domethanë te sheshi i flamurit ishin bërë ni grup i madh me policë edhe kishin marrë ca njerëz edhe rrafshin ni doktor. Nuk më kujtohet emri. Aq shumë e rrafshin policia ni doktor shqiptar sa kur e kemi pa na u çmendshim.

Djalit e tij, ai ka patur flokët e gjata. E kishin kap kështu për flokësh {tregon me duar e kanë kapur për flokë mrapa kokës} edhe i mshonin sa mundeshin me automatik, me diçka kështu në shpinë. Bërtiste ai djali. Ai djali ka qenë me siguri nja 18-19 vjeçar. Atë doktorin e kishin shtri për toke edhe i mshojshin sa mujshin me shkelma. Kur e pam na normal u shqetësua shumë. Im shoq e kthej rrugën se mos e kthe ec drejt, çka ndodhë si dihet. Sa kemi kalu aty te rruga për në, ku shkon për Graçanicë, akoma pa shku për Graçanicë është ni përpjetëze policia edhe aty.

Veç na ka thanë, “Nëse doni me kalu”... na pa. Unë e kisha vajzën 17 vjeçe djalin 16 vjeç. Ishin moshë shumë të ndishme. Thotë, “Nëse doni me ecë”, thotë, “pare”. Çka ka pasë im shoq, mesa e di i morëm me veti nja tre mijë marka në atë kohë, komplet ia ka dhanë. Është e vërtetë se s’ken’ t’u na lanë me kalu. I morën paret edhe shkum. Përsëri na ndalën edhe niherë tjetër. E mori atë lejën e kalimit, “Dokumentat”, i tha, “pse”, tha, “është e shprazët?” Burri jem tha, “S’kam, m’i morën atje”, edhe kalum, fati. Shkum mandej arritëm në kufi, s’patëm problem deri në kufi. Në kufi veç u vonuam nja shtatë-tetë orë. Fati të nesërmen mandej janë blloku atje komplet në Stankovec po ne kalum.

Unë e kisha dajën, vëllaun e nanës e kisha në Shkup. Momentalisht nja dhjetë ditë nejtëm në shtëpinë e tij por u mblohdëm shumë nga Kosova që kishin familjartë e tonë. Pastaj shkum në Tetovë. Na gjetën ni banesë njerëz të cilët jetonin në Zvicër dhe i kishin lëshu tetovarët krejt banesat. Ndejtëm aty tre muaj, afër tre muaj sa i ra. Shumë domethanë kushtet ishin ideale po normalisht ajo ishte s’kam çka flas se e dijnë krejt Kosova çfarë gjendje. Përsëri ne mirë por kanë qenë ata më keq që ishin nëpër kampe. Ata e kanë patur ma vështirë.

Ne nuk kaluam keq kështu, po du me thanë nga ana ekonomike, fjetjes e qëndrimit por shqetësimet ishin shumë të mëdhaja normalisht. Se nuk e dinin se çfarë do të ndodhte nesër derisa u kthym pastaj dhe u shliku Kosova.

Anita Susuri: A jeni kthy menjëherë?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Po menjëherë pas, mbas dy ditësh derisa jemi nisë, po, meniherë.

Anita Susuri: Në çfarë gjendje e gjetët vendin?

Ferdeze Mujaj Sadiku: E kur erdha pastaj banesa ka qenë e rujtun, domethanë e pa prekur, ndërsa farmacia ka qenë komplet, komplet, komplet e shkatërruar. Domethanë gjithçka çka ka ekzistuar, të

gjitha ato barnat që kanë qenë, aq sa tre herë që kam unë sot... sepse ne mendonim ndoshta bëhet luftë por ne si farmaci do të punojmë se farmacia është diçka për shëndet edhe ka nevojë. Ashtu na mori mendja edhe e mbushëm plot farmacinë.

Krejt çka patëm të ardhurat e paratë i shtinëm aty. Kur erdhëm e gjetëm komplet, komplet, komplet të shkatërruar. T'thyer me xhama, me rafta me krejt. Nuk ka ekzistuar asni gja aty ma, komplet e shkatërruar. Dy muj e diçka normalisht nuk punova më. Filllova me punu në të shtetit atëherë fillim kishe në shtetërore u mbyllën edhe ato. Rivazhdova përsëri edhe këtu pastaj në... jam edhe sot.

Anita Susuri: Mirë zonja Ferdeze, nëse doni diçka me shtu për fund?

Ferdeze Mujaj Sadiku: Jo, unë ju falënderoj juve që m'keni zgjedhë për t'biseduar me mu po ndoshta unë nuk jam meritore për këtë bisedë me ju. Ju kam lodhë. E di që nuk kam bërë kurrë keq diçka në jetën time, ndoshta nuk kam bërë mirë por të këqija s'kam bërë kurrë. E dua Shqipërinë sa nënën time ndoshta sepse krejt çka kam nga ajo kohë normalisht që edhe sjelljet e mia kanë qenë ashtu siç duhet, siç kanë kërku. Por edhe këtu ku jetoj sepse këtu kam lind sepse Shqipëria e Kosova është një, nuk mund t'i ndaj absolutisht.

Bile saherë shkoj në Shqipëri, ndihem, bile sidomos në Vlorë edhe në Tiranë por në Vlorë më tepër, ndihem... qaj saherë shkoj dhe gjithmonë gjithmonë nuk ka shansë të shkoj në Vlorë dhe të mos shkoj ta vizitoj shkollën. Patjetër shkoj e vizitoj shkollën. Gjithashtu edhe në Tiranë shkoj. Kam shku disa herë edhe në Laç këtu ku kam ndejtë, kam shku edhe në Tropojë edhe në Bajram Curr. Nuk e di, i kam ato kujtimet që m'kanë mbetur mu në mendje dhe nuk mund t'i shlyj.

Bile shpesh më kritikojnë edhe njerëzit, "Pse", thonë, "nuk ke tregu realitetin çfarë ka ndodhë në Shqipëri? Çfarë ka qenë?" Thom, "Unë me atë sy e kam pa Shqipërinë atëherë, nuk mund t'i ndryshoj sytë e mi, nuk mund ta ndryshoj mendjen time". Kjo jam unë. Ndoshta kam gabuar por megjithatë ka pasur Shqipëria gjana të mira që shumë njerëz i kërkojnë tani. Ka patur edhe gjana që nuk u dashtë të ndodhin në asni mënyrë por Shqipëria ishte ni vend feudal. Nga ni feudalizëm me kalu... bëri gjithë ato ndërtime, gjithë atë ushtri, gjithë atë industri fundi fundit.

Ajo rryma elektrike që është sot që e ka Shqipëria është e asaj kohe, nuk kanë investu ma asgjë mesa di unë. Është Vau i Dejës që e kanë bo, që është ndërtu e që është elektrifiku Shqipëria. Nejse, megjithatë edhe niherë të falënderoj që m'keni zgjedhë, m'keni respektu, m'keni nderu. Kjo është nder për mua.

Anita Susuri: Faleminderit juve! Ishte knaqësi.

Ferdeze Mujaj Sadiku: Jo, faleminderit juve!